

AKT NORMATIV
Nr.2, datë 16.6.2010

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7746, DATË 28.7.1993 “PËR HIDROKARBURET
(KËRKIMI DHE PRODHIMI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) “Marrëveshja Albpetrol” lejon Albpetrolin (“Albpetrol” sh.a.), të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet. Ministria, që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve për këtë qëllim.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha